



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

---

## **KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**

**Raporti vjetor i punës**  
**për vitin 2012**

**drejtuar**

**Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**mars 2013**

**Telefoni:** 038 245 031  
**Telefaksi:** 038 245 034  
**Ueb faqja:** [www.kpm-ks.org](http://www.kpm-ks.org)  
**E-mail:** [info@kpm-ks.org](mailto:info@kpm-ks.org)

## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE .....	5
BAZA LIGJORE .....	7
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE.....	8
Përbërja .....	8
Historiku i nominimeve .....	8
Emërimi i anëtarëve të KPM-së.....	8
Aktivitetet e KPM-së .....	9
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE .....	10
ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE .....	10
PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE .....	12
Personeli.....	12
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS .....	12
Monitorimi i Pajtuëshmërisë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore .....	12
Monitorimi i Pajtuëshmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerçiale Audio-vizuale .....	13
Televizioni Publik i Kosovës- RTK.....	13
Televizionet nacionale: TV21 dhe KTV.....	13
Televizionet regjionale, lokale dhe OSHP-të.....	13
Monitorimi për respektimin e të drejtës së autorit .....	14
Monitorimi i Pajtuëshmërisë së Ofruesëve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së .....	14
Pajtuëshmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuele.....	14
Monitorimet sipas ankesave.....	15
Vizitat/inspektimet tek ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuele .....	15
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT .....	15
Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës .....	15
Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhëve:.....	15
Numri Operatorëve Kabllorë të licencuar:.....	16
Ofruesit e Shërbimeve Programore (OSHP).....	16
Njoftimi për pagesën e taksës për licencë.....	16
Shqyrtimi i kërkesave .....	17
Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2013 .....	17
DEPARTAMENTI LIGJOR.....	17

Rastet kundër transmetimeve ilegale .....	17
Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerçiale Audio-vizuale KKPM 2009/04; .....	18
Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore CIMC 2009/01 .....	18
Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës .....	18
Transmetimet pa të drejtën autoriale.....	18
Rastet për shkeljen e Rregullores KKPM 2010/01– .....	19
Rastet për mosparaqitjen së raportit vjetor .....	19
Rasti e Shkeljes së Ligjit të KPM-së- Neni 21, paragrafi 1 .....	19
Transmetimi pa Licencë.....	19
Rastet tjera të proceduara nga Departamenti Ligjor .....	20
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR .....	21
Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge.....	21
Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....	21
Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova, Radio Blue Sky, Radio 21 dhe Radio Dukagjini) .....	21
Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal .....	22
Rastet për interferencë .....	22
Rastet për transmetime të palicencuara.....	22
Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare.....	22
Gjetja e frekuencave të lira .....	22
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE .....	23
Buxheti .....	23
BORDI I ANKESAVE .....	25
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2013 .....	26
ZHVILLIMI I POLITIKËS SË TRANSMETIMIT .....	26

## SHTOJCAT

Shtojcën I	Raporti Vjetor Financiar
Shtojcën Ia	Raporti Vjetor Financiar
Shtojca II	Raporti nga konferenca : “Digjitalizimi tokësor televiziv - Praktikrat Evropiane & Rajonale”
Shtojca III	Organogrami
Shtojca IV	Pajtueshmëria e Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore
Shtojca V	Raport monitorimi lidhur me Pajtueshmërinë e Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës
Shtojca VI	Raporti përmbledhës pajtueshmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet mediale Audio-vizuale
Shtojca-VII	Paraqitja tabelare e Rasteve Ligjore

## PARATHËNIE

Ju përcjellim raportin e aktiviteteve të Komisionit të Pavarur të Mediave, për periudhën kohore janar-dhjetor 2012.

Në fillim të vitit 2012 janë miratuar ligjet për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Televizionin Publik të Kosovës (RTK).

Pas 20 muajve, që kur Komisioni i Pavarur për Media kishte mbetur pa Këshill, Kuvendi i Republikës së Kosovës bëri emërimin e pesë (5) anëtarëve të Komisionit më 30 gusht 2012, duke i mundësuar institucionit të KPM-së edhe vendimmarrjen.

Komisioni në përbërje të re së bashku me Zyrën Ekzekutive vazhdoi punën për të realizuar objektivat institucionale të caktuara më parë. Prioritet edhe në vitin 2012 ishte angazhimi për dorëzimin e Draft Strategjisë për transmetimin digjital në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Në fokus të aktivitetit ishte përshpejtimi i punës në vendosjen e kriterëve bazike për formimin e kornizës së përgjithshme, e cila do të ndihmojë në përcaktimin e politikës së përshtatshme të shtetit të Kosovës për procesin e kalimit nga transmetimi analog në atë digjital.

Përderisa me Ligjin e KPM-së është paraparë që të ketë edhe Ligj për digjitalizim, ky ligj në bashkëpunim me partnerët tjerë do të hartohet nga Ministria për Zhvillim Ekonomik

Nga Ligji i ri për KPM-në kanë rrjedhur disa obligime që të rishikohet baza ligjore sekondare. Për ta realizuar këtë synim KPM-ja gjatë muajit tetor 2012 ka punuar në amandamentimin e rregulloreve të saj, të cilat janë dërguar edhe për dëgjim publik tek të licencuarit e KPM-së në muajin nëntor 2012.

Komisioni i KPM-së ka trajtuar edhe rastet të cilat janë grumbulluar për një periudhë për më shumë se dy vite, në mungesë të organit vendim-marrës të këtij institucioni.

KPM-së i është ofruar përkrahje e vazhdueshme nga organizatat ndërkombëtare. Komisioni Evropian ka ndihmuar me angazhimin e ekspertizës për hartimin e draft strategjisë për digjitalizim, kurse OSBE-ja ka ofruar ekspertë për çështje të digjitalizimit, i cili ka dhënë kontribut edhe në rishikimin e akteve nënligjore.

KPM-ja që nga viti 2003 është anëtare e Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullative (European Platform of Regulatory Authorities/EPRA). Më 24 nëntor të vitit 2012 KPM-ja është anëtarësuar në Rrjetin e Autoriteteve Rregullative të Mesdheut (Mediterranean Network of Regulatory Authorities), organizma këta që i mundësojnë KPM-së bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash me autoritetet tjera rregullatore evropiane të fushës audio-vizuale.

Gjatë vitit 2012 KPM-ja ka vlerësuar pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuale me të gjitha rregulloret e Komisionit të Pavarur të Mediave, si dhe ka inspektuar të licencuarit.

Vlerësimi i pajtueshmërisë është bërë përmes monitorimeve të rregullta dhe të kategorizuara sipas akteve nënligjore.

Gjatë zbatimit të Ligjit për KPM-në tek rregullimi i komunikimeve komerciale audiovizuale, kemi hasur në një problematikë, të cilën KPM nuk ka mekanizëm se si ta evitojë. Konsiderojmë se ligjvënësi duhet që në mënyrë sa më të shpejtë të mundshme ta rishikojë mundësinë që neni 17 i ligjit për RTK-në, të riformulohet apo të hiqet, ashtu që të gjindet zgjidhja më e përshtatshme për financimin e RTK-së si medium publik, pasi që neni 17 i ligjit të RTK-së, që e rregullon çështjen e reklamave, nëse vazhdon të jetë në këtë mënyrë edhe për një kohë të gjatë, në masë të madhe dhe pa të drejtë është duke i dëmtuar TV-të komerciale.

Tjetër shqetësim vazhdon të mbetet, në të shumtën e rasteve, mos kategorizimi i duhur i përmbajtjeve programore, mosrespektimi i kohës për transmetim të programeve, si dhe mos sinjalizimi dhe njoftimi paraprak për përmbajtjet e dëmshme programore. Monitorime janë bërë edhe për komunikimet komerciale, kodin e sjelljes dhe të drejtën e autorit. Për secilën shkelje të evidentuar, janë ndërtuar raste sipas rregullave të procedurës në pajtim me Ligjin e KPM-së. Për shkelje më të rënda dhe për të cilat nuk është arritur pajtueshmëri pavarësisht veprimeve të KPM-së, janë aplikuar sanksionet me gjobë. Krahas monitorimeve, janë hapur raste ligjore ex officio por edhe të inicuar nga ankesat e publikut.

Në Kosovë në fillim të vitit kanë operuar 21 TV Stacione, 83 Radio Stacione, 14 Operatorë Kabllorë dhe 49 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP). KPM-ja ka licencuar në fund të vitit edhe RTK 2 (si OSHP); 10 Ofrues të Shërbimeve Programore dhe 2 operatorë kabllorë.

Duke marrë në konsideratë kërkesat e shumta që janë parashtruar në KPM gjatë viteve, por edhe nevojën e disa prej regjioneve të Kosovës që të kenë mbulim me sinjal tokësor lokal radio televiziv, janë bërë analiza të spektrit frekuencor për të gjetur frekuenca të lira të cilat gjatë vitit 2013 do të ofrohen për konkurrim për t'ju shërbyer qytetarëve të Kosovës.

Për vitin 2013, si Komision i kemi vënë vetes synim që të realizojmë disa objektiva të rëndësishme si për zhvillimin e politikës audiovizive poashtu edhe për vet institucionin e KPM-së. Prioritet parësor mbetet finalizimi i ndryshimit të të gjitha akteve nënligjore të KPM-së me ndryshimin e Rregullores për Operatorët Kabllorë, Kodit të Sjelljes; dhe Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës; Hartimi i Ligjit për Digjitalizim, përkatësisht krijimi i politikave për procesin e digjitalizimit; koordinimi me shtetet fqinje i planit frekuencor digjital (me qëllim që të mos ketë interferime në brezin frekuencor me vendet fqinje); lëshimi i licencave të reja – vendimi i KPM-së për frekuencat lokale, avancimi i bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane, si dhe të gjenden forma dhe mënyra për pranimin e KPM-së në të gjitha institucionet ndërkombëtare, që lidhen me fushën e rregullimit të transmetimit dhe brezit frekuencor radiodifuziv.

**Komisioni i Pavarur i Mediave  
Mars 2013**

## BAZA LIGJORE

Komisioni i Pavarur i Mediave është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) Nr. 04/L-44, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe ka hyrë në fuqi me 20 prill 2012. Në bazë të këtij ligji, përkatësisht Nenit 3, KPM-ja është i vetmi autoritet rregullativ për fushën audio-vizuale, i cili harton dhe miraton politikën e transmetimit si dhe të gjitha aktet nënligjore rregullative për fushën audio-vizuale. KPM është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2.8 KPM-ja *“i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës”*.

## KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

### *Përbërja*

KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative. Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11 pika 2.1. të Ligjit për KPM, i cili përcakton: “brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”.

### *Historiku i nominimeve*

Pas përfundimit të mandatit dyvjeçar të dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, më 27 maj 2012, bazuar në Ligjin e vjetër për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, Nr. 02/L-15, Shefi Ekzekutiv ka kërkuar nominime për zgjedhjen e dy (2) kandidatëve të rinj nga shoqëria civile, tre muaj para skadimit të mandatit të tyre. Afati për nominim ka qenë nga 20 shkurt 2012 deri më 5 mars 2012. Gjatë kësaj periudhe në zyrën e KPM-së janë pranuar gjithsejtë shtatë (7) nominime.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përkatësisht në bazë të nenit 46, KPM-ja është obliguar të bëjë ftesë publike për nominime lidhur me zgjedhjen e shtatë (7) anëtarëve të Komisionit. Afati për nominime të reja ka qenë i hapur nga 25 prill 2012 deri më 16 maj 2012. Më 21 maj 2012, KPM ia ka përcjellë Kuvendit të Kosovës të gjitha nominimet për procedim të mëtutjeshëm deri në emërimin e tyre.

Me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 5 tetor 2012, KPM sërish ka inicuar procedurën për nominime, me ç'rast ka bërë ftesë publike për nominime nga shoqëria civile për emërimin e dy (2) anëtarëve të Komisionit, për të siguruar përfaqësimin gjinor dhe të komunitetit serb. Afati për nominime ka përfunduar më 29 tetor 2012. Gjatë kësaj periudhë, KPM-ja ka pranuar gjithsejtë 8 nominime, të cilat pastaj me 1 nëntor 2012 i ka përcjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës për procedurë të mëtutjeshme deri në emërimin e tyre.

### *Emërimi i anëtarëve të KPM-së*

Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e mbajtur me 30 gusht 2012, ka emëruar 5 anëtarë të KPM-së, si dhe ka përcaktuar me short mandatet e tyre siç parashihet me nenin 13, paragrafi 2, i Ligjit për KPM-në.

Shefki Ukaj-gazetar , Kryetar i KPM-së, me mandat 2 (dy) vjeçar

Xhemajl Krasniqi-Inxhinier i Telekomunikacionit, Nënkyetar i KPM-së, me mandat 4 (katër) vjeçar

Drita Begolli- Prof. Asistent UP, anëtare e KPM-së, me mandat 4 (katër) vjeçar,

Emrush Kastrati-Magjistër i Shkencave Juridike, anëtar i KPM-së , me mandat 3 (tre) vjeçar,

Nevzat Hydaverdi-Magjistër i Shkencave të Kimisë- gazetar, anëtar i KPM-së, me mandat 2 (dy) vjeçar.



Në seancën e mbajtur me 24 dhe 30 janar 2013, pas zhvillimit të procedurës së votimit për zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave Kuvendi i Republikës së Kosovës zgjodhi anëtarin e gjashtë të KPM-së znj. Vesna Jovanović-Prof. i Gjuhës dhe Letërsisë serbe, nga radhët e komuniteti serb, me mandat 3 vjeçar.

### *Aktivitetet e KPM-së*

Pas emërimit të anëtarëve të Komisionit të KPM-së, ka vazhduar puna për hartimin e strategjisë për digjitalizim. Grupet punuese me punën e tyre kanë arritur të përfundojnë vendosjen e kriterëve bazike për formimin e kornizës së përgjithshme, për kalimin nga transmetimi analog në atë digjital.

Draft Strategjia për digjitalizim është përgatitur nga grupet punuese të udhëhequra nga KPM-ja. Pjesë e këtyre grupeve punuese kanë qenë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, mediave, shoqërisë civile.

Grupet punuese kanë vendosur kornizën ligjore, programore, teknike, dhe ekonomiko-shoqërore të kalimit në transmetime digjitale si dhe është bërë planifikimi i strategjisë për fushatën e informimit dhe vetëdijesimin e publikut, për të qenë të gatshëm të pranojnë dhe të jenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm shtetëror. Draft strategjia e finalizuar i është dërguar Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratim më 19 dhjetor 2012. Kjo draft strategji është bazuar në praktika dhe standarde evropiane të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Me Ligjin e KPM-së është paraparë që të ketë edhe Ligj për digjitalizim, i cili do të bazohet në strategjinë e hartuar nga KPM-ja.

Përveç hartimit të draft strategjisë, KPM -ja në një punëtori të mbajtur në Ohër, ka bërë rishikimin edhe të akteve nënligjore, ashtu siç parashihet me ligjin e KPM-së;

- Rregullorja për Komunikimet Komerciale Audio-vizuale
- Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale
- Rregullorja për të Drejtën e Autorit
- Rregullorja e KPM-së për Dhënien e Licencës
- Pjesa 1 - Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së

KPM-ja është duke punuar me përkushtim edhe për plotësimin e Rregullores për Operatorë Kabllorë, si dhe aktet tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fushën e shërbimeve mediale audio-vizuale. Në mënyrë që kjo fushë të rregullohet sa më mirë janë konsultuar praktikantët me të mira të rajonit dhe shteteve të BE-së.

Gjithashtu, KPM-ja në bazë të obligimeve ligjore ka mbajtur takime të rregullta të Komisionit, në të cilat ka marrë vendim për licencimin e 9 Ofruesve të Shërbimeve Programore, një Operator

Kabllor. Komisioni i KPM-së ka trajtuar edhe rastet të cilat janë grumbulluar për një periudhë për më shumë se dy vite, në mungesë të organit vendim-marrës të këtij institucioni.

Komisioni ka marrë këto vendime:

- 1 Vendim për licencimin e RTK 2 (si OSHP);
- 10 Vendime për licencimin e OSHP-ve;
- 2 vendime për licencimin e Operatorëve Kabllorë;
- 4 vendime për ndryshimin e emrit;
- 3 vendime për ndryshimin e pronësisë;
- 2 vendime për revokimin e licencës;
- 6 vendime për refuzim të kërkesave;
- 2 vendime për ndryshimin e lokacionit;
- Vendim për dënim me gjobë- RTV 21 për shkelje të nenit 15 paragrafi 3 të Rregullores për Komunikime Komerciale.
- Vendim për dënim me gjobë- Operatori kabllorë IPKO për shkelje të Ligjit të KPM-së- Neni 21 paragrafi 1
- Vendim për dënim me gjobë -Operatori kabllorë EAGLE për shkelje të nenit 2.1.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës- Transmetimet pa të drejtë autoriale.

## **BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE**

Konform ligjit të ri të KPM-së dhe ART-së, tani ARKEP (Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare), është arritur pajtueshmëria që të arrihet një marrëveshje bashkëpunimi.

KPM-së i është ofruar përkrahje e vazhdueshme nga organizatat ndërkombëtare. Kështu, Komisioni Evropian ka ndihmuar me angazhimin e ekspertizës për hartimin e draft strategjisë për digjitalizim, kurse OSBE ka ofruar ekspertë për çështje të digjitalizimit, i cili ka dhënë kontribut edhe në rishikimin e akteve nënligjore. Gjithashtu, OSBE i ka mundësuar KPM-së një vizitë studimore tek rregullatori i Kroacisë.

KPM-ja që nga viti 2003 është anëtare e Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullative (European Platform of Regulatory Authorities/EPRA). Më 24 nëntor të vitit 2012 KPM-ja është anëtarësuar në Rrjetin e Autoriteteve Rregullative të Mesdheut (Mediterranean Network of Regulatory Authorities), organizma këta që i mundësojnë KPM-së bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash me autoritetet tjera rregullatore evropiane të fushës audio-vizuale.

## **ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE**

Më nëntor 28 dhe 29 qershor 2012, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka organizuar konferencën ndërkombëtare me temën “DIGJITALIZIMI TOKËSOR TELEVIZIV - PRAKTIKAT EVROPIANE & RAJONALE” rreth procesit të digjitalizimit.

Qëllimi i konferencës ishte prezantimi i procesit të digjitalizimit të transmetimeve, diskutimi i sfidave e përvojave praktike, teknike dhe ligjore në vendet Evropiane dhe ato nga rajoni, me qëllim të ndarjes së përvojave nga ky proces. Në konferencë ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve kosovare, përfaqësues të medias kosovare, përfaqësuesit e agjencioneve përkatëse nga vendet e rajonit, përfshirë Kroacinë, Slloveninë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, si dhe përfaqësues nga Britania e Madhe dhe Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullative (EPRA). (*Shtojca II- Raporti i konferencës*)

Gjithashtu, pas hyrjes në fuqi të Ligjit të amandamentuar për Komisionin e Pavarur të Mediave nr. 04/L-44, Zyra Ekzekutive e KPM-së në maj 2012 ka organizuar takime regjionale me përfaqësues të shërbimeve mediale audio-vizuale, me qëllim të njoftimit të tyre me ndryshimet dhe efektet e miratimit të Ligjit për KPM-në.

Po në këtë takim është bërë prezantimi i punës së rasteve të proceduara dhe procedurat për rishikimin e bazës ligjore sekondare për rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuale në Republikën e Kosovës

## PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

### *Personeli*

Në fillim të vitit 2012, Zyra Ekzekutive ka funksionuar me një staf prej 31 punëtorësh, ndërkaq nga data 1 janar 2012 deri më 31 dhjetor 2012, nuk ka pasur procedurë të rekrutimit, (**Shtojca III- Organogrami**)

### DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS

Departamenti i Monitorimit dhe Analizave (DMA), gjatë vitit 2012 ka vlerësuar pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuale me të gjitha rregulloret e Komisionit të Pavarur të Mediave. Gjetjet pas realizimit të aktiviteteve të sipërshënuara dhe rekomandimet e këtij Departamenti, ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të KPM-së, kanë mbështetur shumë veprime të mëtutjeshme.

#### *Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore*

Projekti i parë i monitorimit, i realizuar në vitin 2012, ishte projekti për vlerësimin e pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuale me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore, në të cilin janë përfshirë televizionet me mbulim nacional, regional e lokal, si dhe ofruesit e shërbimeve programore.

Ndonëse përkufizimet në rregullore për përmbajtjet e dëmshme programore (frikën, dhunën, erotikën, pornografinë) janë shumë të qarta, të gjeturat nga ky monitorim kanë dëshmuar se shumica e televizioneve dhe ofruesve të shërbimeve programore janë gjetur në shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore.

Shkeljet me të shpeshta të identifikuar me rastin e monitorimeve ishin ato për kategorizimin jo të duhur të përmbajtjeve programore, mosrespektimin e kohës për transmetim të programeve, si dhe mos sinjalizimin dhe njoftimin paraprak për përmbajtjet e dëmshme programore.

Gjatë këtij aktiviteti janë identifikuar edhe raste të transmetimit të spoteve muzikore me tekste vulgare dhe skena erotike e të dhunës, të cilat janë në kundërshtim me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtja e Dëmshme Programore, e të cilat janë transmetuar pa kurrfarë paralajmërimi për përmbajtje të dëmshme programore.

Gjatë monitorimeve, janë identifikuar edhe spote muzikore, tekstet e të cilave glorifikojnë efektet pozitive të substancave narkotike dhe të cilat haptas bëjnë thirrje për përdorimin e tyre, gjë që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve, dhe t'i inkurajojë ata për sjellje devijante.

Me qëllim të parandalimit të ndikimit negativ të përmbajtjeve programore dhe spoteve muzikore me tekste vulgare e skena erotike dhe të dhunës, KPM-ja ka dërguar shkresa tek të gjitha shërbimet mediale audio-vizuale. Përmes tyre u ka bërë thirrje televizioneve dhe OSHP-ve që të jenë më të vëmendshme në përzgjedhjen e përmbajtjeve programore dhe kohën e transmetimit të

tyre, duke zhvendosur emetimin e tyre në orët e vona të mbrëmjes, atëherë kur fëmijët zakonisht nuk janë pranë ekraneve televizive.

Monitorimet lidhur me pajtueshmërinë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbytjet e Dëmshme Programore janë bërë në vazhdimësi. (***Shtojca IV- Raporti përmbledhës***)

### ***Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale***

Në monitorimin e bërë, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale, ishin të përfshira televizionet nacionale, televizionet regjionale e lokale, si dhe ofrues të shërbimeve programore (OSHP) të cilët transmetojnë komunikime komerciale.

Krahas monitorimeve për sasinë e reklamave të transmetuara brenda një ore program, monitorimet janë bërë edhe për vendosjen e produkteve, sponsorime, top-shopin dhe dispozitat tjera të Rregullores për Komunikime Komerciale.

### ***Televizioni Publik i Kosovës- RTK***

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për RTK-në, i cili përmban dispozita edhe për komunikime komerciale, DMA ka bërë disa herë monitorimin e pajtueshmërisë së Radio Televizionit të Kosovës me nenin 17 të Ligjin për RTK-në.

Përderisa Rregullorja për Komunikime Komerciale u lejon shërbyesve audio-vizuel komercial, që brenda një ore të transmetojnë 12 minuta komunikime komerciale, Televizioni Publik, sipas ligjit për RTK-në, mund të emitojë komunikime komerciale deri në dhjetë përqind (10%) të vëllimit të tërësishëm programor.

Gjetjet nga monitorimi dëshmojnë se RTK ka vepruar në pajtueshmëri.

### ***Televizionet nacionale: TV21 dhe KTV***

Monitorimet e televizioneve tjera komerciale, TV 21 dhe KTV kanë dëshmuar se këto televizione kanë vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Komunikime Komerciale, përkatësisht me nenet 15.3 dhe 16.3 të Rregullores për Komunikime Komerciale, të cilat kanë bërë me kohëzgjatjen e komunikimeve komerciale dhe teleshopingun.

### ***Televizionet regjionale, lokale dhe OSHP-të***

Sipas monitorimeve të 19-televizioneve lokale dhe 5 ofruesve të shërbimeve programore (OSHP), të përfshira në këtë projekt, në shkelje të kësaj Rregulloreje janë gjetur: TV Men, TV Iliria, TV Syri, TV Besa, TV Opinion, TV Dukagjini, Klan Kosova, TV Festina, ON TV. Pas Njoftimeve për Shkelje, kanë vepruar në pajtueshmëri: TV Dukagjini, TV Syri Vision, TV Besa, TV Opinion, ON TV dhe ZIKO TV.

Shërbimet mediale audio-vizuele të gjetura në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale janë monitoruar në vazhdimësi.

### *Monitorimi për respektimin e të drejtës së autorit*

Gjetjet pas monitorimeve të bëra, dhe rekomandimet e KPM-së për shërbimet mediale audio-vizuale, që të veprojnë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Licencës-Kapitulli për të Drejtat e Autorit, kanë rezultuar me pajisjen e shumë shërbimeve mediale me marrëveshje për të drejtën e autorit.

Gjatë këtyre monitorimeve, vëmendje e posaçme i është kushtuar edhe pajtueshmërisë së operatorëve kabllorë (OK) me Kushtet dhe Termet e Licencës së tyre dhe në veçanti identifikimit të kanaleve që ri-transmetohen nga OK-dhe posedimit të kontratave valide për ritransmetimin e tyre.

Vlerësimi i pajtueshmërinë me të drejtën e autorit është intensifikuar veçmas në periudhën e organizimit të kampionateve, ligave futbollistike dhe ndeshjeve të tjera sportive gjatë vitit 2012.

### *Monitorimi i Pajtueshmërisë së Ofruesëve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së*

Vlerësimi i pajtueshmërisë me Pjesën 3 të Kushteve dhe Termeve të Licencës, përkatësisht me formatin e programit, është një aktivitet tjetër i DMA-së, i cili kishte për qëllim analizimin e formatit dhe strukturës programore të programit një javor, i cili mundësoi krijimin e një pasqyre më të saktë për pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese me skemën programore.

Nga ky monitorim është gjetur se përkundër disa ndryshimeve në formatin dhe strukturën e programit, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale në periudhën monitoruese kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së – Formatin e Programit.

Gjithashtu, monitorimi ka dëshmuar se disa televizione lokale e ofruesit e shërbimeve programore (OSHP) kanë filluar t'i konsolidojnë programet e veta, në mënyrë që segmenteve të ndryshme të audiencës së tyre tu ofrojnë diversitet programesh si: program të shërbimit publik dhe program argëtues, në pajtim me skemat e deklaruar programore (***Shtojca V- Raporti përmbledhës***)

### *Pajtueshmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale*

Është konstatim nga monitorimi një javor, se shërbimet mediale audio-vizuale, me përjashtim të TV Most, kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale, duke siguruar korrektësi dhe paanshmëri në raportimet e tyre.

Përkundër faktit se gjatë vlerësimit të balancës në raportim, përgjithësisht nuk është hasur në ndonjë shkelje, DMA konsideron se shërbimet mediale duhet të balancojnë më mirë disa storje e sidomos ato më problematike, për të cilat përveç këndvështrimeve të të dy palëve, është mirë të jepen edhe këndvështrime të ndonjë pale të tretë, apo një burimi shtesë, që e kompletton raportimin.

Përderisa, gjatë monitorimeve të mëparshme, DMA ka hasur në raste kur janë identifikuar emrat, fotografitë ose detaje tjera të personave të arrestuar, gjatë monitorimit një javor për vlerësimin e pajtueshmërisë me Kodin e Sjelljes, nuk janë identifikuar shkelje të kësaj natyre, që dëshmon se

gjatë periudhës monitoruese janë respektuar dispozitat e Kodit të Sjelljes, të cilat kanë të bëjnë me privatësinë dhe të drejtat individuale.

Gjetjet nga këto monitorime janë përmbledhur në raportin i dhënë në shtojcën VI i cili përmban vlerësimin për pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuale me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale. (*Shtojca VI- Raporti përmbledhës*)

#### *Monitorimet sipas ankesave*

Gjatë vitit 2012, në KPM janë parashtruar 15 ankesa lidhur me shkeljet e mundshme nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuale. Me qëllim të vlerësimit të bazueshmërisë së këtyre ankesave, DMA ka bërë monitorime të detajuara si dhe analiza të përmbajtjeve të apostrofuara, pas të cilave ka bërë rekomandime tek departamentet tjera.

#### *Vizitat/inspektimet tek ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale*

Gjatë vitit 2012, stafi i DMA ka realizuar vizita dhe inspektime tek të gjitha radiot, televizionet, ofruesit e shërbimeve programore dhe operatorët kabllorë të licencuar.

## **DEPARTAMENTI I LICENCIMIT**

### *Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës*

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për shërbime mediale audiovizuale, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së. Gjatë vitit 2012, një i licencuar për transmetim të radio programit në gjuhën serbe ka heq dorë nga licenca e KPM-së për arsye financiare. Kështu që, gjatë vitit 2012 kanë operuar gjithsej 21 TV Stacione, 83 Radio Stacione, 14 Operatorë Kabllorë dhe 49 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit kabllor.

### *Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhëve:*

*Të licencuara 21 TV stacione:*

- 1 TV stacion publik;
- 14 TV stacione në gjuhën shqipe;
- 5 TV stacione në gjuhën serbe;
- 1 TV stacion në gjuhën turke.

*Të licencuara 83 Radio stacione*

- 2 radio stacione publike;
- 45 radio stacione në gjuhën shqipe;
- 25 radio stacione në gjuhën serbe;
- 3 radio stacione në gjuhën boshnjake;

- 2 radio stacione në gjuhën turke;
- 2 radio stacione në gjuhën gorane;
- 1 radio stacion në gjuhën rome;
- 3 radio stacione multietnike.

### ***Numri Operatorëve Kabllorë të licencuar:***

*Të licencuar 14 operatorë kabllorë*

- 9 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë shqiptarë;
- 2 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë goranë;
- 3 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë serbë.

### ***Ofruesit e Shërbimeve Programore (OSHP)***

*Gjithsej janë të licencuar 49 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit kabllor.*

- -47 OSHP janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;
- -2 OSHP janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën serbe përfshirë këtu RTK2

### ***Njoftimi për pagesën e taksës për licencë***

Departamenti i Licencimit, për vitin 2012, ka përcjellë shkresat në formë të njoftimit të subjekteve transmetuese, rreth afatit të pagesës së taksës për licencë, duke iu theksuar edhe shumën për pagesë.

Gjatë vitit 2012, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 31 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për TV kanale, kërkesa për frekuenca për radio transmetime, kërkesa për licencë të OSHP-së, kërkesa për licencë të operatorëve kabllorë, ankesa për ndërhyrje në frekuencë të subjekteve transmetuese, kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit dhe njoftime për ndërprerjen e transmetimit.

- 6 kërkesa për frekuencë të radios;
- 2 kërkesa për TV kanale;
- 12 kërkesa për licencë të Ofrueseve të Shërbimeve Programore(OSHP);
- 2 kërkesa për licencë të Operatorëve Kabllorë;
- 2 kërkesë për ndryshim të lokacionit të transmetimit;
- 1 kërkesë për ndryshimin e emrit;
- 2 njoftime për ndërprerjen e transmetimit;
- 1 ankesë për ndërhyrje në frekuencën e transmetimit;
- 3 kërkesa për ndryshime të pronësisë;



### *Shqyrtimi i kërkesave*

Duke marrë parasysh që gjatë vitit 2011, KPM-ja ka funksionuar pa organin vendimmarrës dhe nuk ka pasur mundësi ligjore që kërkesat të cilat janë pranuar gjatë këtij viti t'i shqyrtojë, prandaj këto kërkesa janë bartur për shqyrtim në vitin 2012.

Pas konstituimit të Komisionit, D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Më 31 dhjetor 2012, KPM-ja ka marrë vendim për licencimin e kanalit të dytë të Televizionit të Kosovës, i cili do të funksionojë në kuadër të Radio Televizionit të Kosovës, duke e ofruar programin e tij nëpërmjet rrjetit të operatorëve kabllorë.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2012 janë marrë këto vendime për licencim:

- *Vendimi për licencimin e RTK 2 (si OSHP);*
- *10 Vendime për licencimin e OSHP-ve;*
- *2 vendime për licencimin e operatorëve kabllorë;*
- *4 vendime për ndryshimin e emrit;*
- *3 vendime për ndryshimin e pronësisë;*
- *2 vendime për revokimin e licencës;*
- *6 vendime për refuzim të kërkesave;*
- *2 vendime për ndryshimin e lokacionit; pezullim i kërkesave (3 raste).*

### *Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2013*

- *3 kërkesa për licencë të OSHP-ve;*
- *1 kërkesë për licencë të Operatorëve Kabllorë;*
- *2 kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit;*
- *1 kërkesë për ndryshim të pronësisë dhe lokacionit të transmetimit.*

## **DEPARTAMENTI LIGJOR**

Departamenti Ligjor (DL) gjatë vitit 2012, ka shqyrtuar raste të ndryshme të shërbyesve medial audio-vizuel për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe ankesa të personave fizik dhe të organizatave të ndryshme, ndaj shërbyesve medial, që i janë drejtuar KPM-së.

Varësisht nga lloji i dispozitave ligjore të shkelura nga ana e shërbyesve për media audio-vizuele, rastet e proceduara janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

### *Rastet kundër transmetimeve ilegale*

Gjatë vitit 2012, janë proceduar njëzet e tetë (28) raste për shkeljen e nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton : “Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilin e lëshon KPM-ja”, dhe neni 30, paragrafi 5, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton : “Kushdo që operon pa leje valide transmetimi i konfiskohet

*aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa”.*

Rastet e proceduara për shkeljen e dispozitave të sipërshënuara janë paraqitur në tabelën 1 të shtojcës VII ( ***Shtojca VII Paraqitja tabelare e Rasteve Ligjore***) të këtij raporti dhe kanë të bëjnë me njëzet e tetë (28) operatorë kabllorë, të cilët operojnë pa licencë të KPM-së në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar Urdhra këtyre operatorëve për ndërprerje të transmetimit ilegal.

#### ***Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KKPM 2009/04;***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2012, ka proceduar pesë (5) raste kundër subjekteve transmetuese, që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale KKPM 2009/04:

- TV 21 ka bërë shkelje të nenit 15, paragrafi 3, të Rregullores KKPM-2009/04, për tejkalim të minutazhit të lejuar për reklamim. TV 21 edhe pas pranimit të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me shkrim ka dështuar të vije në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2009/04. KPM si rezultat i shkeljeve të vazhdueshme të Rregullores KKPM-2009/04 ka marr Vendim që TV 21 t'i shqiptojë dënim me gjobë.

Ndërsa katër (4) raste tjera pas Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me Shkrim të dërguar nga ana e KPM-së kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2009/04. Rastet janë mbyllur.

#### ***Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore CIMC 2009/01***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2012, ka proceduar tetë (8) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore CIMC-2009/01.

Pas Njoftimeve për Shkelje të dërguara nga KPM-ja këta shërbyes medial audio-vizual kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC 2009/01. Rastet janë mbyllur.

#### ***Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës***

##### ***Transmetimet pa të drejtën autoriale***

Edhe gjatë vitit 2012, çështja e respektimit të drejtës së transmetimit ka qenë problem kyç si për industrinë mediale ashtu edhe për KPM-në. Shërbyesit e mediave audio-vizual sipas Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës obligohen që të respektojnë të drejtën e transmetimit, duke siguruar marrëveshje valide për transmetimin dhe ritransmetimin e të gjitha e programeve.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2012, ka proceduar dymbëdhjetë (12) raste për shkelje të së drejtës autoriale:

- Operatori Kabllorë EAGLE- shkelja e nenit 2.1.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me shkrim

operatori kabllorë EAGLE ka dështuar të vije në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës. Komisioni i KPM-së ka marr Vendim që operatorit kabllor EAGLE t'i shqiptojë dënim me gjobë.

Ndërsa 11 rastet tjera pas Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me Shkrim dhe Urdhrit të dërguar nga ana e KPM-së kanë ardhur në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me përjashtim të subjektit transmetues TV Zoom, i cili bartet për procedim për vitin 2013. Rastet janë mbyllur.

#### ***Rastet për shkeljen e Rregullores KKPM 2010/01–***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2012 ka proceduar gjashtëdhjetë e një (61) raste lidhur me shkeljen e Rregullores së KKPM-së 2010/01:

Zyra e KPM-së nga këto raste 44 prej tyre u ka dërguar Njoftim për Shkelje, Vërejtje me shkrim dhe Urdhër. Këta 44 shërbyes medial audio-vizuel nuk kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2010/01. Këto raste barten në vitin 2013 dhe do të procedohen në Gjykatën Ekonomike.

Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes me shkrim dhe Urdhrit 17, subjektet tjera kanë arritur pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/01, duke bërë pagesën e taksës për Licencë. Rastet janë mbyllur.

#### ***Rastet për mosparaqitjen së raportit vjetor***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2012 ka proceduar gjashtëdhjetë e tri (63) raste lidhur me shkeljen e nenit 28 të Ligjit të KPM-së:

Zyra e KPM-së nga këto raste 34 prej tyre ju ka dërguar Vërejtje me shkrim. Këta 34 shërbyes medial audio-vizuel nuk kanë ardhur në pajtueshmëri me nenin 28 të Ligjit të KPM-së, duke mos e sjellur raportin vjetor. Komisioni i KPM-së ka marr Vendim që këtyre subjekteve t'i shqiptojë masë sanksionuese me Vërejtje.

Ndërkaq, 29 shërbyes medial audio-vizual pas Vërejtjes me shkrim kanë ardhur në pajtueshmëri me nenin 28 të Ligjit të KPM-së, duke sjellë raportin vjetor.

#### ***Rasti e Shkeljes së Ligjit të KPM-së- Neni 21, paragrafi 1***

##### ***Transmetimi pa Licencë***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2012 ka proceduar një (1) rast lidhur me shkeljen e nenit 21, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së. Operatori kabllor IPKO ka bërë shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së dhe për këtë Departamenti Ligjor i ka dërguar Njoftim për Shkelje dhe Vërejtje. Pala nuk ka ardhur në pajtueshmëri. Komisioni si rezultat i shkeljes së vazhdueshme të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, ka marrë Vendim që operatorit kabllor IPKO t'i shqiptojë dënim me gjobë.

### *Rastet tjera të proceduara nga Departamenti Ligjor*

Gjatë viti 2012 janë proceduar gjashtë (6) raste:

- Rasti i parë, është proceduar bazuar në ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje ndaj RTK, në ankesë thuhet se RTK ka përdorur terma të gabuara dhe jo të drejtë duke e quajtur lëvizjen Vetëvendosje parti politike e jo subjekt politik, siç është përcaktuar me Ligjin për zgjedhjet. KPM-ja i ka dërguar shkresë RTK-së për shkelje të nenit 3, paragrafi 1 dhe nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01. Rasti është mbyllur.
- Rasti i dytë, është proceduar bazuar në ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje ndaj RTK-së, në ankesë thuhet se RTK gjatë raportimit të protestës së Vetëvendosjes ka qenë e pa balancuar dhe e njëanshme. Pas vlerësimit të ankesës nga ana e Departamentit Ligjor, KPM-a ka konstatuar se RTK nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01 veprim ky për të cilën është njoftuar edhe Lëvizja Vetëvendosje. Rasti është mbyllur.
- Rasti i tretë, është proceduar bazuar në ankesën e Federatës Sindikale të Bujqve ndaj subjekti transmetues publik RTK, për shkak të transmetimit të lajmeve të pavërteta lidhur me FSBK-në , duke vepruar kështu si medium i njëanshëm. Pas vlerësimit të ankesës nga ana e Departamentit Ligjor, KPM-ja ka konstatuar se RTK nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01, veprim ky për të cilën është njoftuar edhe Federata Sindikale e Bujqve. Rasti është mbyllur.
- Rasti i katërt, është proceduar bazuar në ankesën e KPU INSPECT ndaj subjektit transmetues publik RTK. Në ankesën e KPU INSPECT ceket se RTK ka transmetuar kronikë në lajmet qendrore, duke e akuzuar KPU INSPECT. Pas vlerësimit të ankesës nga ana e Departamentit Ligjor KPM-ja ka konstatuar se RTK nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01, veprim ky për të cilën është njoftuar edhe KPU INSPECT. Rasti është mbyllur.
- Rasti i pestë, është proceduar bazuar në ankesën e z. Arben Zharku ndaj subjektit transmetues KTV. Në ankesën e z. Zharku është cekur se KTV ka transmetuar një lajm shumë tendencioz ndaj drejtorit të QKK-së Fatos Berisha, ku pjesë e lajmit ka qenë edhe deklarata e z. Zharku marr më parë e cila është shkurtuar dhe devijuar. Pas vlerësimit të ankesës nga ana e Departamentit Ligjor, KPM -ja i ka dërguar shkresë KTV-së për shkelje të nenit 3, paragrafi 1, nenit 4, paragrafi 4, dhe nenit 12, paragrafi 4, të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01. Rasti është mbyllur.
- Rasti i gjashtë, është proceduar bazuar në ankesën e z. Bujar Gjokolli ku thuhet se KTV ka transmetuar një kronikë në lajme qendrore, duke bërë shpifje dhe fyerje ndaj personalitetit të z. Gjokolli. Pas vlerësimit të ankesës nga ana e Departamentit Ligjor të KPM-së ka konstatuar se KTV ka bërë shkelje të nenit 3, paragrafi 1, të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale KKPM 2010/01, duke i dërguar kështu KTV-së Njoftim për Shkelje. Rasti është mbyllur.

## DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

### *Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge*

Gjatë vitit 2012, janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës. Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio e televizive që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2011, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

### *Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)*

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e painterferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm me 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimi i rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m ) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar, ashtu që të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

### *Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova, Radio Blue Sky, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)*

Mbulimi i territorit të Republikës së Kosovës me sinjale radio FM nga subjektet transmetuese ( Radio Kosova, Radio Blue Sky, Radio 21 dhe Radio Dukagjini) është rreth 90 % e territorit,

me përjashtim që në disa lokacione të vendit (segmente të caktuara rrugore me relief kodrinor) kualiteti dhe niveli i sinjalit është i dobët.

### *Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal*

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e painterferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës.

Televizionet regjionale – lokale mbulojnë rreth **68.14%** të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth **96.98%** të territorit të Kosovës.

### *Rastet për interferencë*

Gjatë vitit 2012 DMF, ka pranuar vetëm tri ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese. Raportet e detajuara lidhur me këto tri ankesa rezultojnë se në njërin ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetuese, që është ankuar, kurse në dy raste tjera jo.

- TV Opinioni është interferuar nga TV Besa në rajonin e Prizrenit.
- Radio Focus ( Rahovec), është konstatuar se ka pasur probleme me transmetuesin dhe nuk ka pasur interferime nga jashtë.
- Radio 21 është ankuar për interferencë nga Radio Plus (Prishtinë). Pas matjeve është konstatuar që radio 21 nuk është i interferuar por ka pasur probleme me sistemin e transmetimit.

### *Rastet për transmetime të palicencuara*

DMF ka proceduar me rastet për TV Zoom dhe Radio Hit Laser, që transmetojnë programet e tyre nga lokacioni Maja e Gjelbër, lokacion për të cilin nuk janë të licencuar.

### *Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare*

DMF gjatë vitit 2012 ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio dhe televizive që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja.

Frekuencat që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare , nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës.

### *Gjetja e frekuencave të lira*

Gjatë vitit 2012, DMF ka bërë matje dhe analiza për frekuencat të lira në ato lokacione, ku KPM-ja ka paraparë si të nevojshëm ndonjë subjekt të ri transmetues. Frekuencat të lira janë paraparë për TV lokale në: Prishtinë, Mitrovicë, Podujevë, Kaçanik, Fushë Kosovë, Reçan dhe Mamushë, ndërsa për frekuencat të lira për Radio FM lokale në: Lipjan, Junik, Hani i Elezit dhe Mamushë.

## DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

### *Buxheti*

Komisioni i Pavarur i Mediave është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Për vitin 2012, KPM-së i është ndarë buxhet prej 977,651 Euro, duke përfshirë të hyrat vetanake prej 212,000 Euro, të hyrat vetanake të bartura nga viti 2011 në shumën prej 73,712 Euro dhe investimin kapital prej 240,000 Euro.

Për periudhën janar-dhjetor 2012, Komisioni i Pavarur i Mediave ka shpenzuar buxhetin në vlerë prej 668,403 euro apo 68%.

<b>Buxheti i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012</b>				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe mëditjet	248,169	248,169	232,619	15,550
Mallra dhe Shërbime	186,770	186,770	178,416	8,354
Shërbime Komunale	17,000	17,000	16,980	20
Shpenzimet Kapitale	240,000	240,000	0.00	240,000
Të Hyrat	212,000	212,000	166,676	45,324
Të Hyrat e bartura 2011		73,712	73,712	
Total:	903,939	977,651	668,403	309,248

Nga të hyrat vetanake të mbledhura prej taksës së licencës nga subjektet transmetuese janë gjeneruar 221,290 Euro, prej të cilave 214,536 euro i takojnë të hyrave nga licenca, ndërkaq shumat prej 2,088 euro dhe 4,667 euro i takon kamatave për vonesa dhe gjobat.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nga të hyrat vetanake janë shpenzuar mjete në vlerë 240,388 euro apo 84% nga shuma totale prej 212,000 euro dhe të hyrat e bartura 2011 në vlerë prej 73,712 euro.

Mjetet nga të hyrat vetanake janë shpenzuar për realizimin e projektit të hartimit të strategjisë për kalimin nga sistemi analog i transmetimit në atë digjital.

Në pajtueshmëri me Nenin 20.4 të Ligjit për KPM-në, mjetet nga gjobat derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës,.

Projekti i paraparë për ndërtimin e objektit të KPM-së që ishte planifikuar të realizohej në periudhën dy vjeçare (2011 – 2012) në vlerë të përgjithshme prej 690,000 euro ( në vitin 2011 vlera 450,000 euro dhe në vitin 2012 vlera 240,000 euro sipas PIP) nuk është realizuar.

Në vitin 2011 është shpenzuar shuma prej 8,120 euro apo afër 2% nga totali për Projektin Ideor sipas kërkesës së Komunës. Shkak i mos shpenzimit të mjeteve në këtë kategori është mos ndarja e parcelës për ndërtimin e objektit të KPM-së, nga Komuna e Prishtinës. Mjetet e mbetura në vlerë prej 441,880 euro dhe 240,000 janë kthyer në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Mos realizimi i projektit në kategorinë e investimeve kapitale ka ndikuar që buxheti i përgjithshëm të shpenzohet në shkallën prej 68%.

Në shtojcën e parë është dhënë Raporti Vjetor Financiar i detajuar, i cili paraqitet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në Ministrinë e Financave (**Shtojca I Raporti Vjetor Financiar**).

Gjithashtu me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, KPM paraqet Raportin vjetor financiar 2012, në formën standarde të raportimit financiar vjetor, të paraparë për organizatat e pavarura. ( **Shtojca Ia**).



## **BORDI I ANKESAVE**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, bazuar në nenin 38 pika 2.1. i cili përcakton *“brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Bordit apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, Kuvendi i Kosovës në pajtim me Rregulloren e punës nxjerrë shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”*,

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 5 nëntor 2012 me votim të fshehtë të deputetëve ka zgjedhur : Daut Krasniqin, kryetar të Bordit për Ankesa, si dhe anëtarët: Albion Kelmendi dhe Sylejman Klinaku me mandat tre vjeçar.

# OBJEKTIVAT PËR VITIN 2013

## ZHVILLIMI I POLITIKËS SË TRANSMETIMIT

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të KPM-së është inicuar hartimi i akteve nënligjore në pajtim me këtë ligj.

Në vitin 2012 është filluar me ndryshimin e pesë rregulloreve të KPM-së:

- Rregullorja për Komunikime Komerciale Audio-vizuele
- Rregullorja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuele
- Rregullorja për të Drejtën e Autorit
- Rregullorja e KPM-së për Dhënien e Licencës
- Pjesa 1- Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së

Për vitin 2013, prioritet parësor mbetet finalizimi i ndryshimit të të gjitha akteve nënligjore të KPM-së me ndryshimin e

- a) Rregullores për operatorët kabllorë,
- b) Kodit të sjelljes; dhe
- c) Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës.

### **I. PËRCJELLJA E PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT NË TËRË KOMPLESITETIN E VET**

- a) Fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore të KPM-së
- b) Krijimi i kushteve për punë të stafit dhe anëtarëve të KPM-së-ndërtimi i objektit të KPM-së
- c) Krijimi i politikave për procesin e digjitalizimit;
- d) Koordinimi me shtetet fqinjë i planit frekuencor digjital (me qëllim që të mos ketë interferime në brezin frekuencor );

### **II. ZHVILLIMI I PLURALIZMIT MEDIAL QË U SHËRBEN GJITHË QYTETARËVE TË KOSOVËS**

- a) Lëshimi i licencave të reja – vendimi i KPM-së për frekuencat lokale

### **III. MBULUESHMËRIA E ZONAVE TË VEÇANTA GJEOGRAFIKE TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (rrugëve magjistrale dhe regjionale) ME SINJAL KUALITATIV TË PROGRAMEVE TE RADIO PROGRAMEVE ME MBULUESHMËRI NACIONALE**

**IV. KRIJIMI I KUSHTEVE PËR ARKIVIMIN AFATGJATË TË PROGRAMEVE TË MONITORUARA (afati ligjor 7 vite)**

**V. AVANSIMI I BASHKËPNIMIT ME AUTORITETET RREGULLATIVE EVROPIANE:**

- b) Angazhimi i KPM-së - Koordinimi me institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, për pranimin e KPM-së në të gjitha institucionet ndërkombëtare, që lidhen me fushën e rregullimit të transmetimit dhe brezit frekuencor radiodifuziv.

**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**